

**AKT NORMATIV**  
**Nr. 14, datë 7.4.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË AKTIN NORMATIV NR. 9, DATË 22.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E TEKSTIT TË MARRËVESHJES, NDËRMJET MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK DHE DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR “KEYMEN ILAÇ SANAYI VE TICARET” A.Ş, PËR FURNIZIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME VAKSINËN E INAKTIVIZUAR KUNDËR COVID-19 (VERO CELL) CORONAVAC, TË KRIJUAR NGA SINOVA LIFE SCIENCE CO, LTD. DHE TË PRODHUAR NË REPUBLIKËN POPULLORE TË KINËS”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në aktin normativ nr. 9, datë 22.3.2021, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Titulli i aktit normativ riformulohet, si më poshtë vijon:

“Për miratimin e marrëveshjes së furnizimit, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar “*Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret*” A.Ş”.

**Neni 2**

Në pikën 1, të nenit 1, pas fjalës “... Kinës ...” shtohen fjalët: “... dhe vaksinën *CoronaVac 600 SU IM Suspension* për injeksion të paketuar në një flakon 0,5 ml, e cila përmban substancën aktive antigjenin viral “Sars-CoV-2”, të inaktivizuar, të zhvilluar nga *Sinovac Life Sciences Co., Ltd.*, prodhuar në Republikën Popullore të Kinës dhe që paketohet në Republikën e Turqisë.”.

**Neni 3**

Miratimin e tekstit të marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së furnizimit, ndërmjet Ministrisë Shqiptare të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit Shqiptar të Shtetit për Rindërtim dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar “*Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret A.Ş*”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

**Neni 4**

**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**